

## **Hapet Thirrja për Aplikime për Studentët e Universitetit të Tiranës në Universitetin Kodolanyi Janos, në Hungari, në Kuadër të Programit Erasmus +, për semestrin e parë të vitit akademik 2019-2020**

Në kuadër të programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët e Universitetit të Tiranës në Universitetin Kodolanyi Janos në Hungari, për semestrin e parë të vitit akademik 2019-2020.

### **Llojet e mobilitetit përfshijnë:**

- Shkëmbimin e studentëve për studime

### **Nivelet e mobilitetit për studentët:**

- Bachelor;
- Master;

### **Kohëzgjatja e bursave:**

- Bachelor/Master (4 muaj);

### **Fushat e studimit:**

- Studime Ndërkombëtare;
- Studime Sociale;
- Studime Kulturore;
- Shkenca Humane;
- Turizëm;
- Biznes;

<http://edu.kodolanyi.hu/prospective-students/programs/erasmus/guide-to-fall-semester-studies/>

<https://edu.kodolanyi.hu/wp-content/uploads/2019-2020-fall-catalogue.pdf>

### **Bursat përfshijnë:**

- Kompensimin mujor (750 EUR në muaj për studentët);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT ( <a href="http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm">http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm</a> )	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni link-ut:

[http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance\\_en.htm](http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus + nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe/ose tarifën e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

➤ **Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit Bachelor:**

-CV (në gjuhën angleze);

-Kopje e Pasaportës;

-Vërtetim studentit;

-Listë notash (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze);

-Letër Motivimi në gjuhën angleze;

-Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht B1/ Hungarisht B1 në varësi të programit të studimit);

-\*Learning Agreement;

*\*Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillojë në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë ‘Before the mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

*KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin Kodolanyi Janos lëndë të njëjta me ato që do të kryeni në semestrin e parë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ata që do të zhvillojë në fakultetin tuaj semestrin e dytë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvillojë lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.*

Dokumenti "Learning Agreement" tek seksioni "Commitment" firmoset fillimisht nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe më pas në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:

[http://www.unitir.edu.al/images/learning\\_agreement\\_studies\\_Kodolanyi\\_Janos.docx](http://www.unitir.edu.al/images/learning_agreement_studies_Kodolanyi_Janos.docx)

-Application form. Për të shkarkuar formatin e Application form klikoni në linkun e mëposhtëm:

[http://www.unitir.edu.al/images/Kodolanyi\\_Janos\\_application\\_form\\_erasmus.docx](http://www.unitir.edu.al/images/Kodolanyi_Janos_application_form_erasmus.docx)

➤ **Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit Master:**

-CV (në gjuhën angleze);

-Kopje e Pasaportës;

-Vërtetim studenti në programin master;

- Diploma e Bachelor; (në mungesë të diplomës vërtetim i përfundimit të studimeve bachelor)

- Listë notash e programit bachelor (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze);

-Listë notash e programit master (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze);

-Letër Motivimi në gjuhën angleze;

-Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht B1/ Hungarisht B1 në varësi të programit të studimit);

-\*Learning Agreement;

*\*Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë "Before the mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

*KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin Kodolanyi Janos lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e parë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ata që do të zhvillohenit në fakultetin tuaj semestrin e dytë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvilloheni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.*

*Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset fillimisht nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe më pas në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.*

*Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:*

[http://www.unitir.edu.al/images/learning\\_agreement\\_studies\\_Kodolanyi\\_Janos.docx](http://www.unitir.edu.al/images/learning_agreement_studies_Kodolanyi_Janos.docx)

-Application form. Për të shkarkuar formatin e Application form klikoni në linkun e mëposhtëm:

[http://www.unitir.edu.al/images/Kodolanyi\\_Janos\\_application\\_form\\_erasmus.docx](http://www.unitir.edu.al/images/Kodolanyi_Janos_application_form_erasmus.docx)

### **Afati për aplikime për bursa: 10 Maj 2019**

Dokumentet duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Studentët, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al).

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al).

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!